



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:252855

Datë: 30.11.2023

Numri i dokumentit: 04996036

PPP. nr. 65/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të Kreditorit F.../Kosove degë e Organizatës F..., Institucioni mikrofinanciar zyra qendrore në Prishtinë e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A.K, kundër debitorëve F.B dhe M.S nga Komuna Gllogoc, lidhur me borxhin në shumën prej 5,212.17 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit V.B, P.nr... të datës 24.04.2019, jashtë seance me datë 29.11.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorëve F.B dhe M.S, nga Komuna Gllogoc, ushtruar kundër Urdhërit të Përmbaruesit Privat P.nr... të datës 24.04.2019 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit për përmbarimin e borxhit në shumën prej 5,212.17 €, ndërsa **Urdhri** i Përmbaruesit Privat P.nr... i datës 24.04.2019 **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat V.B, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Kontratës Mbi Huan me nr... e datës 10.04.2015 i cili është dokumenti besueshëm i cili sipas Nenit 21 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit ndërsa në bazë të Nenit dhe 29 të këtij ligji është dokument i besueshëm.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit, në afat ligjor debitorët kanë paraqitur prapësim në bazë të Nenit 69, 70, 71 të LPP-së, me arsyetimin se debitorët asnjëherë nuk kanë pranuar nga Kreditori dhe kanë theksuar se Borxhi i kërkuar nga Kreditori është i parashkruar pasi që realizimin e shumës si në Marrëveshje – Kontratën e huasë me nr... datë 10.04.2015 është krijuar me datë 10.04.2015 ndërsa kërkesa- propozimi për përmbarim është bërë me datën 23.04.2019 dhe në bazë të dispozitave të Neneve 355 dhe 357 të LMD-së, dhe Nenit 71 par.1 pika 1.4 të LPP-së kanë konsideruar se propozimi për përmbarim i kreditorit duhet të hudhet si i pa bazuar, tutje shtoj faktin se debitori kishte paguar më shumë se gjysmën e kredisë së marr dhe me datë 23.04.2019 nuk kishte arritur të paguaj këstin e radhës, po ashtu shtojnë faktin se traktori IMT... nuk është pjesë e marrëveshjes - kontratës për kredi dhe se garantuesja R.B nuk ishte garantuese në kontratë, mirëpo i njëjti thekson se është i gatshëm të vazhdoje pagesën e kësteve si dhe të respektoj marrëveshjen, poashtu e ka kontestuar në tërësi dokumentin në fjalë

duke menduar se nuk janë përmbushur elementet e dokumentit të besueshëm nga Neni 22 të LPP-së, dhe ka kërkuar nga gjykata që të mbajë seancë gjyqësore për tu dëgjuar palët në mënyrë që të vërtetohet drejtë gjendja faktike, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj urdhërin përmbarimor me nr... datë 24.04.2019.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigjeje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorëve me arsyetimin se debitorët kundërshtimin e ushtruar ka theksuar se asnjëherë nuk e ka pranuar nga kreditori një kërkesë të tillë, as personalisht as përmes postes, pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë pasi që kemi **provat dhe vërejtjet edhe letër vërejtjet të dërguara të cilat edhe i kemi bashkangjitur e të cilat nuk ka pranuar ti nënshkruaj asnjëherë**, ndërsa në kundërshtimin e paraqitur me pretendimin se **borxhi është parashkruar** nuk qëndron pasi që Neni 341 par. 2 përcakton se *“Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”*. Për sqarim i kanë bashkangjitur edhe provën e gjendjes së borxhit të datës 23.04.2019 si dhe Marrëveshjen e huas me nr... të datës 10.04.2015 me të cilën vërtetohet se debitorëve i është lejuar huaja në shumën prej 5000 Euro në afat kthimi prej datës 10.04.2015 deri me datën 24.12.2019, tutje shtojnë faktin se klienti tani **debitorët janë në vonesë në shtatë këste** e jo siç ka pretenduar debitori vetëm në këstin e radhës, ndërsa sa i përket kolateralit Traktorit IMT... është Çertifikata e regjistrimit të pengut në MTI, nënshkrimet e debitorit në marrëveshjen e huas ku thotë se *“pengdhënësi është i pajtimit që kredinë të sigurojë me këto sende të luajtshme Rimorko vlera 1500 Euro traktori IMT... nr. Serik... vlera 3500 Euro*, duke i propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës në përgjithësi të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhërin të mbetet në fuqi.

Gjykata lidhur me këtë çështje nuk ka mbajtur seancën konform Nenit 73 par.1 të LPP-së, pasi që vlerësoj se ka prova të mjaftueshme dhe e ka të qartë për të vendosur mbi këtë çështje përmbarimore.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit i datës 03.05.2019 është i pabazuar, me faktin se: në shkresat e lëndës gjendet **Kontrata për Huan me nr... e lidhur me datën 10.04.2015** mes Kreditorit F... dhe Debitorëve F.B dhe M.S me të cilën janë pajtuar për kushtet dhe mënyrën e kthimit të kredisë si dhe **afatin e që është caktuar në Nenin 3 të kontratës për huan dhe atë nga data 10.04.2015 deri me datën 24.12.2019 përkatësisht për 56 muaj**, dhe se me **Nenin 8** të kësaj kontrate vërtetohet fakti se pengdhënësi ka lënë peng Traktorin IMT... me nr. Serik... dhe Rimorkio.

Nga prova siç është **Vërejtja me shkrim e datës 08.09.2016** vërtetohet fakti se Kreditori i ka bërë thirrje Debitorit F.B që të bëj pagesën e këstit pasi që ka rënë në vonesë duke i bërë me dije se për pasojat ligjore, po ashtu një vërejtje i është bërë edhe bashkë huamarrëses tani debitorës M.S të cilët i është bërë me dije se janë në vonesë në pagesën e këstit të 13-të i cili është dashur të paguhet me datën 07.04.2016 ku e njëjta është njoftuar me pasojat ligjore në rast të mos pagesës së kredisë.

Nga prova materiale siç është **Letër vërejtja e datë 14.02.2019** gjykata ka vërtetuar faktin se debitorët kanë refuzuar që të nënshkruajnë këtë letërthirrje me të cilën debitorët janë paralajmëruar për fillimin e procedurës Përmbarimore ku i kanë bërë thirrje që të kryen obligimet që dalin nga Kontrata e Huas e lidhur me datë 10.04.2015 me nr... ku i ka dhënë afat prej 5 ditësh nga pranimi i kësaj vërejtje.

Nga prova materiale siç është **Çertifikata e regjistrimit të pengut MTI** gjykata ka vërtetuar faktin se lënë peng pasuri e pa luajtshme të pengdhënësit që ka në pronësi në kohën kur është

nënshkruar marrëveshja për pengun siç është Traktori IMT... me nr. Serik... në vlerë të llogaritur 3500 Euro dhe Rimorkio me vlerë prej 1500 Euro.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit në prapësim sa i përket parashkrimit ku vlerësoj së nuk qëndron pretendimi i debitorëve mbi bazën e parashkrimit siç janë thirrur në prapësim pasi që debitorët kanë lidhur Kontratë të huas me kreditorin me datë 10.04.2015 me objekt dhënia e huas në shumë prej 5000 Euro dhe afati i pagesës ka qenë prej datës 10.04.2015 deri me datën 24.12.2019, dhe debitori gabimisht është thirrur në parashkrim duke bërë llogaritje të gabuar të afatit të parashkrimit pasi që ditën rrjedhëse të parashkrimit e ka marr datën 10.04.2015 datën e nënshkrimit të kontratës që është i gabuar, ngase në bazë të kontratës mbi huan vërtetohet se palët janë pajtuar **që pagesa e kësteve të bëhet nga data 10.04.2015 deri me datën 24.12.2019** e që i bie se ky është afati kur debitori në mënyrë vullnetare e paguan huan, debitori ka pasur afat deri me datën 24.12.2019 të paguaj huanë mirëpo i njëjti ka rënë në vonesë dhe nuk i është përmbajtur marrëveshjes, dhe si rrjedhojë e kësaj debitori ka kaluar afati për përmbushje vullnetare të borxhit.

Gjykata pas analizimit të të gjitha provave që gjenden në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se Debitorët kanë rënë në vonesë në pagesën e kështit nr. 13 e i cili është dashur të paguhet me datë 07.04.2016, dhe nga ajo kohë debitorët nuk kanë paguar kështin dhe nuk e kanë respektuar Kontratën mbi Huan edhe pas paralajmërimeve që i janë bërë nga Kreditori, ndërsa sa i përket parashkrimit gjykata konsideron se nuk ka, kjo për arsye Kreditori ka bërë me kohë paralajmërimin për vonesë dhe me kohë ka paraqitur Propozimin për përmbarim, dhe në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në Nenin 342 par. 2 i cili përcakton se *“Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin”*, dhe mbi bazën e këtij neni rezulton se afati për parashkrimin e kërkesës së kreditorit ka filluar të ecë me datë 25.12.2019 me arsyen se parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e vonesës së debitorit, kurse afati për parashkrim është paraparë me Nenin 355 par.1 të LMD-së i cili përcakton se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*. Andaj gjykata gjeti si të pa bazuar prapësimin e debitorëve.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 21 dhe 29 pasi që Kontratë mbi Huanë është dokument i besueshëm, dhe në bazë të Ligjit të Procedurës Përmbarimore Neni 29 par. 1 përcakton se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike; 2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, andaj gjykata vendosi që të refuzoj prapësimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që faturat konsiderohen të jenë dokumente të besueshme.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par 3 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Dega në Gllgoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 65/22, datë 29.11.2023**

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të LPP-së.